

Ligjërata 11

POLITIKA FISKALE

➔ Në këtë kapitull do të njiheni me:

- *Konceptin e politikës fiskale*
- *Qëllimet dhe llojet e politikës fiskale*
- *Buxhetin qeveritar*
- *Instrumentet e politikës fiskale*
- *Ndërveprimet e politikës monetare dhe fiskale*
- *Pasojat/problemet ekonomike të borxhit qeveritar*

KONCEPTI DHE QËLLIMET E POLITIKES FISKALE

Politika fiskale ka të bëjë me përdorimin e shpenzimeve qeveritare dhe politikën e taksave për të arritur qëllime të caktuara ekonomike dhe sociale

⇒ Këto qëllime ndahen në tri kategori:

- QËLLIMI ALOKATIV – ndikimi i politikave buxhetore të qeverisë në alokimin e resurseve të shoqërisë apo zhvillimin e sektorëve të caktuar
- QËLLIMI SHPËRNDARËS - ndikimi i politikave buxhetore të qeverisë në shpërndarjen - rishpërndarjen e të ardhurave
- QËLLIMI STABILIZUES - ndikimi i qeverisë në inflacion, papunësi dhe rritje ekonomike

“Politika fiskale ka të bëjë me politikën e shpenzimeve qeveritare për blerje mallrash e shërbimesh e për kryerjen e pagesave të transferueshme nga njëra anë, dhe me politikën e sigurimit të të ardhurave e para se gjithash të taksave në anën tjetër”

BUXHETI QEVERTAR DHE POLITIKA FISKALE

⇒ BUXHETI QEVERTAR:

- TË ARDHURAT (A): taksat nga të ardhurat personale dhe të korporatave, doganat, taksat mbi sigurimet pensionale, etj.
- SHPENZIMET E QEVERTISË (G): arsim, mirëqenie, siguri, etj.

⇒ Të ardhurat jo gjithmonë janë të barabarta me shpenzimet e qeverisë prandaj nëse:

$A > G$	<u>suficit buxhetor</u>
$A < G$	<u>deficit buxhetor</u>
$A = G$	<u>buxhet të balancuar</u>

⇒ Deficiti buxhetor mund të mbulohet në dy mënyra:

- Me shtypjen e parave (*por në këtë rast vihet në pyetje pavarësimi i Bankës Qendrore dhe politikat kundër inflacionit*)
- Hua nga publiku (*në këtë rast shtrohet pyetja nëse qeveria është kredibile në sytë e opinionit publik si dhe problemi i kalimit të borxhit në gjeneratat e ardhshme?*)

...BUXHETI QEVERITAR DHE POLITIKA FISKALE

⇒ Politikat e shpenzimeve dhe të ardhurave qeveritare varen nga qëllimet makroekonomike të vetë qeverisë

⇒ Dallojmë:

→ Politikë fiskale ekspansioniste (zgjeruese): $\uparrow G$
(Qeveria ka synim të rrisë AD ose AS)

→ Politikë fiskale restriktive (kufizuese): $\downarrow G$
(Qeveria ka synim të ulë AD ose AS)

→ Politika e të ardhurave (A)
(Qeveria ka synim të ndikoj në politikën e të ardhurave)

LLOJET E POLITIKAVE FISKALE

Në përgjithësi dallojmë këto lloje të politikave fiskale:

- ➔ Zgjeruese aktive
- ➔ Kufizuese aktive
- ➔ Zgjeruese automatike
- ➔ Kufizuese automatike

Tabela.23.1. Llojet e politikës fiskale

	Zgjeruese	Kufizuese
Aktive	- Rritje e shpenzimeve qeveritare - Ulje e taksave - Ose të dyja (1)	- Ulje e shpenzimeve qeveritare - Rritje e taksave - Ose të dyja (2)
Automatike	Kompesim për papunësinë Asistencë sociale (3)	Kompesim për papunësinë Asistence sociale (4)

STABILIZATORËT KRYESORË AUTOMATIKË

Stabilizatorët kryesorë automatik:

- **Ndryshimet automatike të të ardhurave nga taksat:** taksat progresive (rritet norma e taksave me rritjen e të ardhurave).
- > P.sh. nëse bie prodhimi, atëherë të ardhurat nga taksat bien duke rritur kështu relativisht të ardhurat e disponueshme e për pasojë edhe shpenzimet për konsum dhe investime.
- **Pagesat për papunësinë dhe pagesat tjera të transferueshme:** kur rritet papunësia rriten benefitet për të papunët.

Megjithatë, stabilizatorët automatikë kanë dy mangësi:

- **Efektet negative në ofertën agregate:**
- > Taksat progresive mund të dekurajojnë iniciativat dhe punëtorët që të punojnë më shumë
- > Po ashtu ndikojnë në rritjen e inflacionit, pasi ato e kufizojnë prodhimin
- > Pagesat e larta për të papunët bëjnë që të papunët të qëndrojnë më gjatë si të papunë
- **Problemi i pengesës fiskale**
- > Kur ekonomia rritet, këta stabilizatorë e pengojnë rritjen (ulin multiplikatorin)

INSTRUMENTET E POLITIKËS FISKALE AKTIVE

Tradicionalisht deri 50-60 vjet më parë, financat publike janë mbështetur ne tre parime bazë të përcaktuara që në kohën e Adam Smithit:

- ➔ Projektet investive publike: p.sh. rindërtimi i rrugëve, elektrifikimi, ujësjellësi, etj.
- ➔ Projektet publike të punësimit: punësimi në projekte afatshkurtra (p.sh. pyllëzimi, etj.)
- ➔ Ndryshimi i normave të taksave

Shënim:

Këto instrumente kanë ndikim në buxhetin qeveritar duke shkaktuar suficit apo deficit

POILITIKA FISKALE: DISA PARIME

- ➔ Financat publike janë zgjerim i financave të familjes. Nëse familja shpenzon më shumë se të ardhurat e saj atëherë do të ketë varfëri dhe falimentim. E njëjta vlen edhe për buxhetin/qeverinë
- ➔ Buxheti duhet të jetë i balancuar
- ➔ Borxhi qeveritar është një barrë për brezat e ardhshëm
Shënim: Këto parime nuk zbatohen gjithherë
- ➔ Financat moderne dallojnë deficitin strukturor dhe atë ciklik

DEFICITI AKTUAL = DEFICITIN STRUKTUROR + DEFICITIN CIKLIK

Sqarime:

- Deficiti aktual – përfaqëson deficitin faktik në një periudhë të dhënë
- Deficiti strukturor – pjesa e deficitit që vjen si rezultat i politikës fiskale aktive (p.sh. ndryshimi i normës së taksave, shpenzimet për arsim, mbrojtje, etj.)
- Deficiti ciklik – pjesa e deficitit që përcaktohet në mënyrë automatike nga gjendja e ciklit të biznesit

...POILITIKA FISKALE: DISA PARIME

Për të sqaruar konceptet e mësipërme është e nevojshme të dime se:

- ➔ Buxheti aktual: shpenzimet, të ardhurat dhe deficiti faktik
- ➔ Buxheti strukturor: shpenzimet, të ardhurat dhe deficiti nëse ekonomia funksionon në kushtet e prodhimit potencial
- ➔ Buxheti ciklik: shpenzimet, të ardhurat dhe deficiti nëse ekonomia funksionon nën ose mbi nivelin e prodhimit potencial

Shënim:

BUXHETI AKTUAL = BUXHETIN STRUKTUROR + BUXHETIN CIKLIK

NDËRVEPRIMET E POLITIKËS MONETARE DHE FISKALE

- ➔ Politika monetare (PM) dhe politika fiskale (PF) ndihmojnë që të nxjerrin ekonominë nga recesioni
- ➔ Të dyja këto politika janë të drejtuara kah menaxhimi i kërkesës agregate (p.sh. për të mbajtur inflacionin nën kontroll)
- ➔ Nevojitet një koordinim në mes të PF dhe PM
- ➔ P.sh. nëse shteti dëshiron të rrisë kërkesën agregate atëherë rrit shpenzimet qeveritare
- ➔ Ose: për të mbajtur prodhimin në nivelin e dhënë atëherë me anë të instrumenteve të politikës monetare i rrit normat e interesit
- ➔ Problemi: identifikimi i cikleve të biznesit dhe ndryshimi nga një politikë në tjetrën
- ➔ PM dhe PF duhet të kombinohen (koordinohen) për të eliminuar fenomenin e ngushtimit të shpenzimeve private (crowding-out) kur rriten shpenzimet qeveritare

...NDËRVEPRIMET E POLITIKËS MONETARE DHE FISKALE

SI MANIFESTOHET *CROWDING OUT*?

Supozojmë që qeveria rrit shpenzimet e saja për mallra dhe shërbime



Rritet GDP më shumë se sa vlera e shpenzimeve për shkak të multiplikatorit



Kjo ndikon në tregun monetar duke rritur kërkesën për para



Për shkak se oferta është e dhënë (fikse), rritet norma e interesit



Rritja e normës së interesit dekurajon shpenzimet që janë të lidhura – që janë të ndjeshme ndaj normës së interesit




Si rezultat do të ulej efekti i politikës fiskale

Shënim:

Crowding-out lidhet me deficitin strukturor, sepse kur ekonomia është në recesion atëherë nuk ekziston *crowding-out*

...NDËRVEPRIMET E POLITIKËS MONETARE DHE FISKALE

Paraqitja e crowding-out përmes modelit AS=AD sipas pikëpamjes klasike-monetariste




Shënim:

Kur qeveria rrit shpenzimet qeveritare → rritet kërkesa për para → kjo rrit normën e interesit → zvogëlohen investimet private në masë të njëjtë sa ka qenë fillimisht rritja e shpenzimeve qeveritare duke eliminuar efektet e politikës fiskale

...NDËRVEPRIMET E POLITIKËS MONETARE DHE FISKALE

- ⇒ POR: kur ekonomia është në recesion atëherë PF ka ndikim pozitiv
- ⇒ Kur qeveria i rrit shpenzimet atëherë kjo rrit GDP ekuilibër
- ⇒ Kjo sepse ekonomia funksionon nën nivelin potencial (shih pjesën b të figurës 23.2)
- ⇒ Me një kombinim të caktuar të PM dhe PF mund të parandalohet rritja e normës së interesit dhe kështu të parandalohet dukuria e *crowding-out*

Fig. 23.2. Nxitja e investimeve nga shpenzimet qeveritare (a) & (b)



PASOJAT EKONOMIKE TË BORXHIT QEVERITAR

- ➔ Huat e akumuluar nga qeveria për të mbuluar deficitin buxhetor përbëjnë borxhin qeveritar ose publik
- ➔ Kur qeveria ballafaqohet me deficit buxhetor atëherë duhet të marrë hua → borxhi qeveritar ose publik (obligacionet, etj.)
- ➔ Shtimi në borxhin qeveritar çdo vit = deficioni qeveritar
- ➔ Megjithëse deficioni në vete nuk paraqet dukuri negative, si i tillë ai rrit barrën e qeverisë dhe është ngarkesë për ekonominë dhe popullsinë e vendit

PROBLEMET E BORXHIT QEVERTAR

Rritja e borxhit përcillet me disa probleme:

- ➔ Nevoja për ta shlyer borxhin e jashtëm
- ➔ Humbja e efijencës për shkak të rritjes së taksave për të paguar borxhin dhe interesin
 - *Qeveria duhet të rrisë taksat për të paguar borxhin*
 - *Rritja e taksave dekurojan njerëzit për të punuar*
- ➔ Zhvendosja e kapitalit, ku njerëzit mbajnë aktive në obligacione (borxh publik) në vend të aktiveve tjera
 - *Njerëzit mbajnë: letra me vlerë të qeverisë (bono thesari, obligacione), dhe aktive tjera*
 - *Nëse rriten obligacionet nga njerëzit, atëherë zvogëlohen aktivet tjera*

...PROBLEMET E BORXHIT QEVERITAR

Duhet të theksohet se:

- ➔ Borxhi i brendshëm – nuk paraqet ndonjë problem pasi në këtë rast i kemi borxh vetes
- ➔ Borxhi i jashtëm – paraqet ngarkesë për popullsinë e vendit borxhli

Shënim:

Një ndër kushtet e vëna nga BE ndaj vendeve të reja anëtare:

- Deficiti buxhetor vjetor jo më i lartë se 3% e GDP-së
- Borxhi qeveritar nuk duhet të jetë më shumë se 60% e GDP-së

Detyrë

Analizoni shpenzimet dhe të hyrat e qeverisë gjatë periudhës 2001-2008:

- ➔ Identifikoni vitet kur ka pasur deficit dhe kur suficit buxhetor
- ➔ Cilët janë zërat kryesorë të shpenzimeve qeveritare?
- ➔ Cilët janë burimet kryesore të të hyrave qeveritare?